

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE

Nr. 930 REP.  
Nr. 170 KOL.



### KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Ne Tirane, sot me daten 08.03.2005( dymije e pese ), ne zyren noteriale rruga Reshit Çollaku, Pall. Shallvare, Nr.41, Tirane, para meje noterit Dusho Dusha, midis paleve te meposhteme u lidh kjo kontrate shitblerje kuotash:

**SHITESI: Renis Tershana**, i biri i Agimit dhe i Nevinit, lindur dhe banues ne Tirane, i datelindjes 23.09.1971, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.1244100,

**BLERES: Gjergj Krali**, i datelindjes 02.01.1954, lindur ne Shkoder, identifikuar me pasaporten Nr.0012748, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**OBJEKTI : Shitja e aksioneve te shoqerise " SICRED" sha ne masen 4.9(kater pike nente perqind) nga ana e aksionerit Renis Tershana me cilesine e shitesit dhe blerja e tyre nga Gjergj Krali me cilesine e blesit.**

### PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria "SICRED " sha eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr.30417, date 22.10.2003, me nje kapital themeltar te regjistruar prej 120.000.000(njeqind e njezet milion) leke.


Me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme, eshte vendosur ne menyre unanime nga te gjithë aksionieret e shoqerise, miratimi i shitjes se pjeses zoteruese te aksionerit te saj ne kete menyre :Renis Tershana do te shese nga pjesa e tij zoteruese ne kapitalin aksioner te shoqerise pjesen prej 4.9 perqind, me vlere nominale te nje aksioni 1.000((njemije)leke.

**Shitesi**, eshte plotesisht dakord dhe i shet me vullnetin tij te lire dhe te plote blesit, pjesen prej 4.9 perqind te aksioneve zoteruese ne kapitalin aksioner te shoqerise " SICRED" sha.

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*



Nga ana e vet Bleresi, eshte plotesisht dakord qe te bleje pjesen prej 4.9 perqind te aksioneve nga pjesa e aksionerit Renis Tershana qe ai zoteron ne shoqerine "SICRED" sha.

### **CMIMI I SHITJES SE AKSIONEVE DHE MENYRA E PAGESES.**

Vlera e shitjes se aksioneve perkatesisht ne masen 4.9 perqind nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 5.880.000 (pesemilion e teteqind e tetedhjetemije) leke, ose 5.880 aksione, vlere kjo me te cilen eshte vleresuar paketa e aksioneve te shitura nga ana e aksionerit te kesaj shoqerie Renis Tershana, per te cilen eshte rene dakord nga ana e pales blerese.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses cash ne dore.

### **MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE.**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesi Renis Tershana, aksioner i shoqerise "SICRED" sha, humbet pronesine, vetem ne masen 4.9 perqind te aksioneve te pjeses se tij takuese ne kapitalin aksioner te shoqerise se mesiperme.

Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate behet pronar i pjeses prej 4.9 perqind te kapitalit aksioner te shoqerise.

Keshtu, me perfundimin e ketij transaksioni shitblerje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te aksioneve nga ana e paleve ne kete kontrate ne shoqerine "SICRED" sha :

1. **Bleresi Gjergj Krali**, do te zoteroje 4.9 perqind te kapitalit aksioner te shoqerise..

2. **Shitesi Renis Tershana** pas ketij trasaksioni do te zoteroje 28.6 perqind te aksioneve te shoqerise "SICRED" sha.

### **KLAUZOLA SHITESI TE KONTRATES**

Shpenzimet noteriale, te avokatit dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.



Kontrata hartohet ne pese kopje te njejta, nga te cilat nje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise dhe nje kopje prane noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time.

**SHITESI**

**Renis Tershana**


*Renis Tershana*

*Renis*

**BLERESI**

**Gjergj Krali**

*Gjergj Krali*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE

Nr. 931 REP.  
Nr. 171 KOL.

PULLE TAKSE



**KONTRATE SHITJE AKSIONESH**  
(Me rezerve te prones)

Ne Tirane, sot me daten 08.03.2005( dymije e pese ), ne zyren noteriale rruga Reshit Çollaku, Pall. Shallvare, Nr.41, Tirane, para meje noterit Dusho Dusha, midis paleve te meposhteme u lidh kjo kontrate shitblerje aksionesh me rezerve te prones :

**SHITESI:** Renis Tershana, i datelindjes 23.09.1971, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.1244100, i njohur personalisht prej meje,

**BLERES:** Gezim Balisha, i datelindjes 14.01.1962, identifikuar me pasaporten Nr.Z 1033900, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje,

**OBJEKTI :** Shitja e aksioneve te shoqerise " SICRED" sha ne masen 4.5(kater pike pese perqind) nga ana e aksionerit Renis Tershana me cilesine e shitesit dhe blerja e tyre nga Gezim Balisha, ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise "SICRED" sha, si bleres.

**BAZA LIGJORE :** Neni 705, 746 dhe 747 i Kodit Civil.

**PERMBAJTJA E KONTRATES**


Shoqeria "SICRED " sha eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr.30417, date 22.10.2003, me nje kapital themeltar te regjistruar prej 120.000.000(njeqind e njezet milion) leke.

Me vendimin Nr.1, date 08.03.2005, te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionerve te shoqerise "SICRED" sha, eshte vendosur ne menyre unanime nga te gjithë aksioneret e shoqerise, miratimi i shitjes me rezerve e prones te aksioneve te aksionerit Renis Tershana ne masen 4.5 perqind, me vlere nominale te nje aksioni 1.000((njemije)leke, bleresit Gezim Balisha, ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise "SICRED" sha, me kusht qe ky i fundit do te behet pronar i tyre, pasi te kete likuiduar kestin e fundit te pageses shitesit dhe pas miratimit nga Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionerve te shoqerise " SICRED" sha, se shoqeria do te rezultojë me fitim.

*Jules*

*A*

*Alle*  
*B*



**Shitesi**, eshte plotesisht dakord dhe i shet me vullnetin tij te lire dhe te plote bleresit, pjesen prej 4.5 perqind te aksioneve zoteruese ne kapitalin aksioner te shoqerise " SICRED" sha.

Nga ana e vet **Bleresi**, eshte plotesisht dakord qe te bleje pjesen prej 4.5 perqind te aksioneve nga pjesa e aksionerit Renis Tershana qe ai zoteron ne shoqerine "SICRED" sha, si dhe te respektojte zbatimin e dy kushteve te permendura me siper..

### **ÇMIMI I SHITJES SE AKSIONEVE DHE MENYRA E PAGESES.**

Vlera e shitjes se aksioneve perkatesisht ne masen 4.5 perqind nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 5.400.000 (pesemilion e katerqind mije) leke, ose 5.400 (pesemije e katerqind) aksione, vlere kjo me te cilen eshte vleresuar paketa e aksioneve te shitura nga ana e aksionerit te kesaj shoqerie Renis Tershana, per te cilen eshte rene dakord nga ana e pales blerese.

Pagesa ne shumen e mesiperme, eshte rene dakord ndermjet te dyja paleve se do te behet jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses cash ne dore, por me keste. Pas likujdimit te keshtit te fundit te pageses nga bleresi, shitesi detyrohet te leshoje para noterit deklaraten perkatese per respektimin e kushtit te rene dakord ndermjet tyre.

### **MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE.**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesi Renis Tershana, aksioner i shoqerise "SICRED" sha, humbet pronesine, vetem ne masen 4.5 perqind te aksioneve te pjeses se tij takuese ne kapitalin aksioner te shoqerise se mesiperme, vetem pasi bleresi Gezim Balisha, ti kete likujdar pagesen e keshtit te fundit dhe pasi Asamblea e Jashtezakonshme e shoqerise " SICRED" sha, te miratoje se shoqeria rezulton me fitim.

Te dyja palet rane dakord qe keto aksione ne masen 4.5 perqind nuk do te jene te tregtueshme deri ne vertetimin e kushteve te mesiperme.

Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe pas plotesimit te dy kushteve te permendura me lart, behet pronar i pjeses prej 4.5 perqind te kapitalit aksioner te shoqerise.

Keshtu, me perfundimin e ketij transakcioni shitblerje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te aksioneve nga ana e paleve ne kete kontrate ne shoqerine "SICRED" sha :

1. **Bleresi Gezim Balisha**, do te zoteroje 4.5 perqind te kapitalit aksioner te shoqerise, vetem pasi te paguaje keshtin e fundit te pageses shitesit Renis Tershana dhe pas miratimit nga Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionerve te Shoqerise " SICRED" sha, se shoqeria do te rezultojte me fitim.

*Gezim Balisha*

*Renis Tershana*  
33

2. **Shitesi Renis Tershana** pas ketij trasaksioni do te zoteroje 24.1 perqind te aksioneve te shoqerise "SICRED" sha.

### **KLAUZOLA SHITESI TE KONTRATES**


Shpenzimet noteriale, te avokatit dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.

Kontrata hartohet ne pese kopje te njejta, nga te cilat nje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise dhe nje kopje prane noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time.


#### **SHITESI**

**Renis Tershana**


Renis Tershana  



#### **BLERESI**

**Gezim Balisha**

Gezim Balisha  
  
BALISHA  
3

NOTER  
DUSHQ DUSHA





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE  
NOTER PUBLIK DUSHO DUSHA

Nr. 3121 Rep.

IVV. 785 uol.

PULLE TAKSE




### VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane sot me date 22.05.2006 (dymije e gjashte), para meje noterit Dusho Dusha, ne zyren e ndodhur ne rrugen " Reshit Çollaku", Pall Shallavare, Nr.41, Tirane, u paraqit personalisht shtetasi :

**I.Gezim Balisha**, Drejtor i Pergjithshem i shoqerise " SICRED " sha, posedues I pasaportes Nr.Z 1033900, i datelindjes 14.01.1962, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se nenshkrimi ne kerkesen drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, date 19.05.2006, bashkelidhur, bere jashte zyres noteriale, eshte nenshkruar prej tij me deshiren dhe vullnetin e tyre te plote.

Persa me siper une noteri, i bindur per identitetin e kerkuesit dhe rregullshmerine e kerkeses, vertetoj dhe legalizoj nenshkrimin e tij.


NOTER



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE**

Nr. 4302 REP.

Nr. 1070 KOL.



**KONTRATE SHITJE AKSIONESH**

Ne Tirane, sot me daten 30.06.2006 (dymije e gjashte), ne zyren noteriale rruga "Reshit Çollaku", Pall. "Shallvare", Nr.41, Tirane, para meje noterit Dusho Dusha, midis pateve te meposhteme u lidh kjo kontrate shitblerje aksionesh:

**SHITES:**

**1. Shoqeria "Elkons Grup" shpk**, regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr.26243, date 07.09.2001, me Kod Fiskal Nr.3709201, me NIPT K12120004 M, perfaqesuar nga Administratori Arben Taipi, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Komuna e Parisit", pall.3, shk.4, ap.40, i datelindjes 01.04.1965, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.0011949,

**BLERES:**

**1. Petraq Shomo**, i datelindjes 07.01.1963, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Dervish Hekali", Nr.49, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.1594236,

**OBJEKTI** : Shitja e aksioneve te shoqerise "Elkons Grup" shpk ne masen 4(kater) perqind qe ajo zoteron ne kapitalin e Shoqerise "SiCRED"sha dhe blerja e tyre nga Petraq Shomo.

**PERMBAJTJA E KONTRATES**


Shoqeria "Elkons Grup" shpk, eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin Nr.26243, date 07.09.2001.

Me vendimin Nr. 01, date 30.06.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "Elkons Grup" shpk, Arben Taipi, eshte vendosur shitja e aksioneve te shoqerise ne masen 4(kater) perqind, qe ajo zoteron ne kapitalin e shoqerise "SiCRED" sha, shitje kjo qe do ti behet bleresit Petraq Shomo.

Nga ana e bleresit Petraq Shomo, eshte vendosur blerja e te gjitha aksioneve te shoqerise "Elkons Grup" shpk. ne masen 4 (kater) perqind.

Ne kete menyre shoqeria "Elkons Grup" shpk do te shese teresisht aksionet ne masen 4 (kater) perqind qe ajo zoteron ne kapitalin e Shoqerise "SiCRED"sha, e cila si kapital themeltar ka shumen 120.000.000(njeqind e njezet milion) leke.





Nga ana e vet bleresi Petraq Shomo eshte plotesisht dakord qe te bleje 4(kater) perqind te aksioneve te shoqerise " Elkons Grup" shpk.

### **ÇMIMI I SHITJES SE AKSIONEVE DHE MENYRA E PAGESES.**

Vlera e shitjes se aksioneve ne masen 4(kater) perqind nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 4.800.000(kater milion e tete qind mije) leke, vlere kjo me te cilen eshte vleresuar nga ana e ortakut te vetem te shoqerise "Elkons Grup" shpk. per te cilen eshte rene dakord nga ana e pales blerese.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses per te cilen palet kane rene dakord.

### **MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE.**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesi humbet pronesine, ne masen 4(kater) perqind te aksioneve qe ajo zoteron ne kapitalin e shoqerise "SiCRED" sha, duke mos patur ne te ardhmen asnje pretendim pronesie.

Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate, behet pronare i 4 (kater) perqind te aksioneve ne kapitalin aksioner te shoqerise "SiCRED" sha.


Keshtu, me perfundimin e ketij transaksioni shitblerje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te aksioneve nga ana e paleve :

1.Bleresi Petraq Shomo do te zoteroje 4(kater) perqind te aksioneve ne kapitalin e shoqerise "SiCRED" sha.

2.Shitesi shoqeria "Elkons Grup" pas ketij trasaksioni nuk do te zoteroje asnje perqindje te aksioneve ne shoqerine "SiCRED" sha .

### **KLAUZOLA SHITESE TE KONTRATES**

Shpenzimet noteriale, te avokatit dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.





Kontrata hartohet ne pese kopje te njejta, nga te cilat nga nje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise dhe nje kopje prane noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time.

**Pala shitese**

**Shoqeria "Elkons Grup" shpk**

**Administrator i Pergjithshem**

**Arben Taipi**


*Arben Taipi*

**ELKONS-GRUP SHPK  
GENERAL CONTRACTOR  
TIRANA - ALBANIA**

**Pala blerese**


**Petraq Shomo**

*Petraq Shomo*



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERVE TIRANE**

Nr. 4300 REP.  
Nr. 1068 KOL.



**KONTRATE SHITJE AKSIONESH**

Ne Tirane, sot me daten 30.06.2006 (dymije e gjashte), ne zyren noteriale rruga "Reshit Çollaku", Pall. "Shallvare", Nr.41, Tirane, para meje noterit Dusho Dusha, midis paleve te meposhteme u lidh kjo kontrate shitblerje aksionesh:

**SHITES:**

**1. Shoqeria "ACI Engineering" shpk**, regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr.26241, date 07.09.2001, me Kod Fiskal Nr.3709200, me NIPT K12120003 E, perfaqesuar nga Administratori Petraq Shomo, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Dervish Hekali", Nr. 49, i datelindjes 07.01.1963, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.1594236,

**BLERES:**

**1. Arben Taipi**, i datelindjes 01.04.1965, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Komuna e Parisit", pall.3, shk.4, ap.40, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.0011949,

**OBJEKTI :** Shitja e aksioneve te shoqerise "ACI Engineering" shpk ne masen 4(kater) perqind qe ajo zoteron ne kapitalin e Shoqerise "SiCRED" sha dhe blerja e tyre nga Arben Taipi.


**PERMBAJTJA E KONTRATES**

Shoqeria "ACI Engineering" shpk, eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin Nr.26241, date 07.09.2001.

Me vendimin Nr. 01, date 30.06.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "ACI Engineering" shpk, Petraq Shomo, eshte vendosur shitja e aksioneve te shoqerise ne masen 4(kater) perqind, qe ajo zoteron ne kapitalin e shoqerise "SiCRED" sha, shitje kjo qe do ti behet bleresit Arben Taipi.

Nga ana e bleresit Arben Taipi, eshte vendosur blerja e te gjitha aksioneve te shoqerise "ACI Engineering" shpk. ne masen 4 (kater) perqind.

Ne kete menyre shoqeria "ACI Engineering" shpk do te shese teresisht aksionet ne masen 4 (kater) perqind qe ajo zoteron ne kapitalin e Shoqerise "SiCRED" sha, e cila si kapital themeltar ka shumën 120.000.000(njeqind e njezet milion) leke.



Nga ana e vet bleresi Arben Taipi eshte plotesisht dakord qe te bleje 4(kater) perqind te aksioneve te shoqerise "ACI Engineering" shpk.

### **ÇMIMI I SHITJES SE AKSIONEVE DHE MENYRA E PAGESES.**

Vlera e shitjes se aksioneve ne masen 4(kater) perqind nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 4.800.000(kater milion e tete qind mije) leke, vlere kjo me te cilen eshte vleresuar nga ana e ortakut te vetem te shoqerise "ACI Engineering" shpk. per te cilen eshte rene dakord nga ana e pales bleresese.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses per te cilen palet kane rene dakord.

### **MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE.**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesi humbet pronesine, ne masen 4(kater) perqind te aksioneve qe ajo zoteron ne kapitalin e shoqerise "SiCRED" sha, duke mos patur ne te ardhmen asnje pretendim pronesie.

Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate, behet pronare i 4 (kater) perqind te aksioneve ne kapitalin aksioner te shoqerise "SiCRED" sha.

Keshtu, me perfundimin e ketij transaksioni shitblerje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te aksioneve nga ana e paleve :

1.Bleresi Arben Taipi do te zoteroje 4(kater) perqind te aksioneve ne kapitalin e shoqerise "SiCRED" sha.

2.Shitesi shoqeria "ACI Engineering" pas ketij trasaksioni nuk do te zoteroje asnje perqindje te aksioneve ne shoqerine "SiCRED" sha .

### **KLAUZOLA SHITESI TE KONTRATES**

Shpenzimet noteriale, te avokatit dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.



Kontrata hartohet ne pese kopje te njejta, nga te cilat nga nje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise dhe nje kopje prane noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time.

**Pala shitese**

**Shoqeria "ACI Engineering" shpk**

**Administrator i Pergjithshem**

**Petraq Shomo**

*Petraq Shomo*

**ACI-ENGINEERING SHPK**  
**TIRANA ALBANIA**

**Pala blerese**

**Arben Taipi**

*Arben Taipi*

*[Signature]*

**NOTER**  
**DUSHO DUSHA**

*[Signature]*

NOTER  
TIRANE